

Neuchâtel, 6 mars 2023

### **Kuvendi popullor i Valangin-ës**

Zonjë, Zotëri,

Si pjesë e marrëveshjes së bashkimit midis komunave të Corcelles-Cormondèche-s, Neuchâtel-it, Peseux-së dhe Valangin-ës, krijimi i asambleve popullore po merr formë që në gjysmën e parë të vitit 2023. Për komunën e re të Neuchâtel-it, kjo ka të bëjë me vendosjen e një sistemi të demokracisë lokale që i përmbush më së miri pritshmëritë e banorëve. Kushdo që banon në territorin e komunës mund të marrë pjesë në debatet qytetare të kuvendit të zonës së tij.

Për këtë arsye, ju ftojmë në seancën konstitutive të Kuvendit popullor të lokalitetit të Valangin-ës, **ditën e mërkurë, më 29 mars, në ora 19e30, në sallën e shfaqjeve, chemin du Collège 1, në Valangin.**

Me këtë rast, qëllimet dhe parimet themelore të qeverisjes së asambleve popullore, si dhe mjetet dhe instrumentet demokratike në dispozicion të pjesëmarrësve do t'ju parashtrihen përpara se të caktohet zyra, nëpërmjet shortit (me të drejtë refuzimi) midis të pranishmëve.

Raportin e komisionit të asambleve popullore për Këshillin e Përgjithshëm, së bashku me atë të lagjeve, si dhe rregulloret që kanë të bëjnë me kuvendet popullore, të 14 nëntorit 2022, mund ta gjeni në faqen internet të qytetit të Neuchâtel-it, në adresën: [www.neuchatelville.ch/assembleescitoyennes](http://www.neuchatelville.ch/assembleescitoyennes)

Për çdo pyetje shtesë, ju mund të kontaktoni me *Service de la population et des quartiers* nëpërmjet Sportelit të pranimit të Valangin-ës (Bourg 11, tel. 032 857 21 21, e-mail [accueil.valangin@ne.ch](mailto:accueil.valangin@ne.ch).)

Duke shpresuar se kjo ftesë për të marrë pjesë në një mekanizëm të ri të demokracisë lokale do të tërheqë vëmendjen tuaj, ju lutemi të pranoni, Zonjë, Zotëri, respektin dhe përshëndetjet tona më të mira.

Këshilli komunal